



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

Rr. Ukshin Kovaqica, Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Senatit
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 490/004
Dt 26.03.2019

Në bazë të nenit 48, pika 1.3, të Statutit të Përkohshëm, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 19.3.2019, mori:

VENDIM

- I. Refuzohet si e pabazë ankesa e Bashkim Azemit me nr. 1608 të datës 07.11.2018, e paraqitur kundër vendimit të Senatit për përzgjedhjen e personelit akademik në bazë të konkursit plotësues të shpallur më 13.09.2018 të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".
- II. Vërtetohet në tërësi raporti i Fakultetit të Edukimit, për përzgjedhjen e Petrit Islamit dhe Nazan Mustafës në pozitën: Dy asistentë për grup lëndësh nga fusha e pedagogjisë.

Arsyetim

Universiteti i Mitrovicës ka shpallur konkurs plotësues për zgjedhjen e dy asistentëve për grup lëndësh nga fusha e pedagogjisë në Fakultetin e Edukimit

Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 19.3.2019, duke pasur parasysh propozimin e Komisionit për ankesa dhe parashtresa, u pajtua plotësisht me propozimin e Komisionit vlerësues, sepse kandidatët e përzgjedhur i kanë plotësuar të gjitha kriteret për përzgjedhje, si dhe kanë përvojë pune në institucionet e arsimit të lartë. Ndërsa, ankimesi ka moshë më të vjetër sesa 30 vjet, si dhe nuk ka dëshmi për notën mesatare në nivelin master. Në bazë të kësaj që u tha më sipër, Senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, MASHT-it.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurit;
3. Fakultetit;
4. Zyrtarit ligjor.



Prof. dr. Alush Musaj

Kryesues i Senatit